

# Marrëveshje TIP

NDËRMJET SHMFF DHE PËRFITUESVE TË SHËRBIMEVE

NISMA PËR NDRYSHIM SHOQËROR ARSIS PËR SHMFF, BASHKIA KORÇË

## HYRJE

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet shoqatës Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS dhe Bashkisë Korçë e lidhur me datë 13.07.2021 me nr.prot 6013 dhe nr.101 prot,(NISMA) dt.15.07.2021 për zbatimin e projektit “*Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare*” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) me mbështetje të Fondit Social (2021-2023),



## BASHKIA KORÇË

ekipi i Nisma ARSIS ka hartuar dokumentin e marrëveshjes së bashkëpunimit TIP më përfituesit e shërbimit. Ky dokument i vjen në ndihmë ekipit të SHMFF për të dakordësuar paraprakisht me përfituesit e shërbimit, kushtet dhe detyrimet e palëve, para se të bëhen pjesë e shërbimeve të SHMFF.

Hartimi i dokumentit bazohet në nenin 4 të marrëveshjes dhe në zbatim të aktivitetit “*Hartimi i të gjitha politikave të mbrojtjes së klientëve (përfituesve) dhe punonjësve të shërbimit.*”

Dokumenti i Marrëveshjes Tip që lidhet ndërmjet shërbimofruesit SHMFF në Bashkinë Korçë dhe përfituesit të shërbimeve sic janë anëtarët madhorë të familjeve që bëhen pjesë e programeve mbështetëse të SHMFF synon të vendosë institucionalizimin e marrëdhënies ndërmjet palëve si dhe të përcaktojë qartë rolin dhe përgjegjësitë e secilit partner të përfshirë në këtë marrëveshje. Ky dokument është tip, i cili mund të përshtatet sipas numrit të aktorëve të përfshirë në proces si dhe luan një rol shumë të rëndësishëm në dosjen e çdo familje apo individit të përfshirë. Marrëveshja Tip është gjithmonë e shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm si formulari i vlerësimit të nevojave, plani i ndërhyrjes ku përcaktohen përgjegjësitë dhe angazhimet e secilës palë. Sqarojmë se formatet e punës si vlerësimi, plani i ndërhyrjes apo instrumentet e tjerë janë pjesë e paketës së protokollit të punës për ofrimin e shërbimeve në SHMFF. Për të krijuar një panoramë më të qartë se si duhen plotësuar dokumentacioni bashkëngjitur, gjenden format e ilustruara me plotësime si plani i ndërhyrjes ashtu edhe lista e shërbimeve që ofron shërbimofruesi. Të dy dokumentet përshtaten sipas mënyrës, mundësisë dhe planit të aktiviteteve të parashikuara për ndërhyrje në varësi të nevojave të vlerësuara.

**SQAROJMË SE KY DOKUMENT ËSHTË TIP\_SHEMBULL, E CILA SPECIFIKOHET DHE INDIVIDUALIZOHET PËR CDO INDIV/FAMILJE.**

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot më datë \_\_\_/\_\_\_/2022 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve:

**1. Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen** Bashkia Korçë, Lagjia 4 Bulevad Fan Noli 57, Nr tel 0683054030, përfaqësuar nga Përgjegjësja e Shërbimit Znj.

\_\_\_\_\_, këtej e tutje e quajtur shkurtimisht “**SHMFF**”. SHMFF është një strukturë shërbimofruese në Bashkinë Korçë, në varësi të Drejtorisë së Kujdesit Social, e cila ka në fokus të saj fuqizimin e fëmijës dhe familjes nëpërmjet ofrimit të shërbimeve në bazë të nevojave të identifikuara dhe vlerësuara.

dhe

**2. Z/nj.** \_\_\_\_\_, e bija e \_\_\_\_\_, lindur në \_\_\_\_\_, më datë \_\_\_\_\_, me shtetësi shqipëtare, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. \_\_\_\_\_, këtej e tutje e quajtur shkurtimisht “**Përfituesi**”

*Marrëveshje tip bashkëpunimi SHMFF-Përfitues*

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (*Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror*)



## BASHKIA KORÇË

të cilët duke qenë se:

- SHMFF që nga viti 2021 përkrah Përfituesin duke i ofruar një sërë shërbimesh me qëllim fuqizimin e familjes me fokus mbrojtjen dhe plotësimin e të drejtave të fëmijës;
- Përfituesi ka nevojë dhe është i gatshëm të vijojë të përfitojë nga këto shërbime duke treguar mirëkuptim dhe bashkëpunim .

Palët bien në marrëveshje si më poshtë vijon:

### **NENI 1: Kohëzgjatja dhe qëllimi**

- a. Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet për periudhën nga data \_\_\_\_\_ 2022 deri më datë \_\_\_\_\_ 2022, me të drejtë përtëritjeje në vijim të nevojave dhe problematikave të familjes dhe fëmijës. Jo më vonë se tre muajt e parë , palët nënshkruese do të bisedojnë për të përcaktuar nëse kjo marrëveshje do të përtërihet dhe procedurat përkatëse qoftë për përfundimin apo zgjatjen e saj;
- b. **Qëllimi** i bashkëpunimit ndërmjet palëve është sigurimi i ofrimit të shërbimeve sipas nevojave të Përfituesit në përputhje me standardet për të përmirësuar cilësinë e jetesës dhe integrimin në shoqëri të fëmijëve, të rinjve dhe familjeve të tyre.

### **NENI 2: Angazhimet e SHMFF SHMFF**

merr përsipër të:

- ofrojë shërbime mbështetëse për fëmijën, prindërit dhe familjen e tyre, nëpërmjet një stafi të angazhuar dhe të kualifikuar;
- angazhojë një punonjës të dedikuar për të ndjekur dhe menaxhuar problematikën e familjes, (*punonjës social, psikolog, kujdestar, ku mund të jenë më shumë se një person*);
- ndërmjetësojë dhe referojë problematikën e familjes drejt dhe tek struktura të tjera publike/jopublike për nevoja ose çështje që nuk trajtohen nga SHMFF;
- përcaktojë një person kontakti me të cilin komunikon Përfituesi. Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje si person kontakti është Z/znj. \_\_\_\_\_, me detyrë \_\_\_\_\_.
- të koordinojë me strukturën e NJMF/NJVNR në Bashkinë Korçë, monitorimin e ndërhyrjes së shërbimit mbështetës në familje nëpërmjet vizitave në familje në periodicitetin një herë në javë sipas një kalendari monitorimi.

### **NENI 3: Angazhimet e Përfituesit Përfituesi**

merr përsipër të:

- jetë pjesë duke u përfshirë në hartim, të japë gjykimin dhe pëlqimin për planin individual/familjar të zhvillimit, llojet dhe mënyrën e shërbimeve që do t'i ofrohen atij familjes dhe fëmijës/ve;

*Marrëveshje tip bashkëpunimi SHMFF-Përfitues*

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (*Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror*)



## BASHKIA KORÇË

- jetë pjesëmarrës dhe përgjegjës në zbatimin e planit individual të tij, familjes dhe fëmijës/ve.
- jep miratimin për ndarjen e informacionit me aktorë të tjerë, për plotësimin e nevojave apo shërbimeve mbështetëse.
- është pjesëmarrës dhe përgjegjës në zbatimin e kalendarit të dakordësuar për vizitat në familje, për takime në funksion të aktiviteteve në mënyrë të rregullt duke zbatuar oraret dhe detyrimet e caktuara
- Të mundësojë dhe lehtësojë frekuentimin e rregullt të shkollës për fëmijët .
- Të vazhdojë të ndjekë procedurat e nevojshme ligjore për tu ribashkuar me fëmijën.

### **Neni 4: Ndërprerja e njëanshme**

Nëse ka prova të qëndrueshme atëherë secila palë ka të drejtën të ndërpresë në mënyrë të njëanshme marrëdhënien e bashkëpunimit me efekt të menjëhershëm.

Rastet e ndërprerjes mund të jenë si vijon:

**Nga ana e SHMFF vlerësohet procesi i ndërprerjes së shërbimit, kur:**

- a. Përfituesi në mënyrë të përsëritur nuk tregohet bashkëpunues, nuk i përmbahet angazhimeve të tij që lidhen me zbatimin e planit të zhvillimit individual (për të cilin Përfituesi ka dhënë miratimin shkresor paraprakisht).
- b. Në rast se veprimet apo mosveprimet e Përfituesit dëmtojnë mirëqenien e fëmijës/ve atëhere SHMFF menjëherë ka detyrimin të njoftojë shkresërisht apo verbalisht institucionet e përkatëse që të ndërmarrin masat mbrojtëse dhe ndëshkimore që parashikon legjislacioni përkatës në fuqi;
- c. Sjellje të papërshtatshme, të gjitha format e dhunës kundrejt stafit.

**Nga ana e Përfituesi, vlerësohet procesi i ndërprerjes kur konstaton që:**

- Stafi i SHMFF-së nuk ofron shërbimet për të cilat është angazhuar;
- këto shërbime nuk jepen në kohën, cilësinë dhe sasinë e paracaktuar;
- kur këto shërbime çenojnë mirëqenien e fëmijës apo anëtarëve të tjerë të familjes , njofton institucionet përkatëse.

### **NENI 5: Dispozita të fundit**

- a. Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara deri në fund të marrëdhënieve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi.
- b. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.
- c. Pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, janë shtojcat bashkëngjitur saj:

*Marrëveshje tip bashkëpunimi SHMFF-Përfitues*

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



**BASHKIA KORÇË**

- (a) vlerësimi i nevojave të Përfituesit/ familjes,
  - (b) planin përkatës individual të zhvillimit,
  - (c) lista e llojeve të shërbimeve që SHMFF do të ofrojë
  - (d) angazhimet konkrete që marrin përfituesit në zbatimin e planit ;
- d.** Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët. Hartohet në dy kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën palë. Palët e nënshkruajnë këtë marrëveshje me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë.

**Përfituesi**

**Z. / Znj.** \_\_\_\_\_

**Për “Shërbimet Mbështetëse për fëmijën dhe Familjen” Bashkia Korçë**

**Z. /Znj.** \_\_\_\_\_

Shtojca.

**Lista e Shërbimeve që ofron SHMFF**

**Shërbime të menjëhershme:**

*Këtu vendosen të gjitha shërbimet që ofron SHMFF (për tu plotësuar nga stafi i SHMFFsë)*

**Shërbime afatgjatë për të garantuar qëndrueshmërinë e zgjidhjes**

*(Për tu plotësuar dhe përshtatur nga stafi i SHMFF-së në momentin e lidhjes së marrëveshjes)*

*Marrëveshje tip bashkëpunimi SHMFF-Përfitues*

*Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)*



**BASHKIA KORÇË**

- *Ndjekja e planit afat mesëm/afatgjatë të ndërhyrjes duke bashkëvepruar me NJMF dhe institucionet e përkujdesjes për fëmijët/apo rastit apo dhe partner të tjerë*
- *Fuqizim i familjes kur situata e fëmijës/familjes është rrjedhojë e gjendjes ekonomikosociale që përfshin:*
  - *Këshillim dhe lehtësim për punësim( kurse profesionale, mikroinisiativa) ○ Mbështetje administrative ( certifikata, noterizime, dokumentacion per banese sociale, bonus qeraje, ndihmë ekonomike, etj)*
  - *Pagesë qeraje me afat të shkurtër për banesë apo mjedis pune ○ Paketa higjeno-sanitare, paketa ushqimore, veshje, lodra, ○ Orientim drejt burimeve të reja të përfitimit të shërbimeve ○ Mbështetje direkte në bazë të nevojave*
  - *Ndjekje, kujdes shëndetësor dhe arsimor ( pagesa cerdhe, kopesht, libra, material didaktike, ekzaminime mjekësore , etj)*

**PLANI i NDIHMES ( individual apo familjar)**  
*(mund të përdoret kod apo emri i familjes)*

**Shëndeti**

<b>Objektivi</b>	<b>Veprimet/Aktivitetet</b>	<b>Personi përgjegjes dhe koha kur do të kryhet</b>	<b>Data e vleresimit/shqyrtimit</b>	<b>Treguesi i suksesit</b>
Vlerësim i gjëndjes shëndetësore	-shoqërim pranë qendrës shëndetësore - vizita të nevojshme mjekësore	infermierja dhe përfituesi	Brenda javës	Vlerësim i situatës shëndetësore
	-kryerja e ekzaminimeve të nevojshme	infermierja dhe përfituesi	Ne vijim	Shëndet i mirë, dokumentim i ekzaminimeve

*Marrëveshje tip bashkëpunimi SHMFF-Përfitues*

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)

**BASHKIA KORÇË**

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pajisja me libër shëndeti</li> <li>- Kryerja e vaksinave</li> </ul>	infermierja dhe përfituesi	Ne vijim	Librezë vaksinash
	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rimbursim i medikamenteve</li> </ul>	organizata		Fëmija merr mjekimin e nevojshëm për mirësim i gjendjes shëndetësore

**Punësimi**

Objektivi	Veprimet/Aktivitetet	Personi përgjegjes	Data e vleresimit/shqyrtimit	Treguesi i suksesit
Alternative për punësim	-Aplikim pranë zyrës së punës- (lihet takim me përfituesin për orën dhe datën e shoqërimit )	Menaxheri i rastit dhe përfituesi		Punësim
Formim profesional	-Aplikim pranë qendres së formimit profesional ??	Menaxheri i rastit dhe përfituesi	Ne vijim	Kurs Profesional
Keshillim dhe orientim për punësim	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatitja e një CV</li> <li>- Orientim për tregun e punës</li> </ul>	Menaxheri i rastit dhe përfituesi	Ne vijim	Rritje e aftësive për tu orientuar në tregun e punës dhe fuqizim i përfituesit

**Siguria/ Asistenca Ligjore**

Objektivi	Veprimet/Aktivitetet	Personi përgjegjes	Data e vleresimit/shqyrtimit	Treguesi i suksesit

*Marrëveshje tip bashkëpunimi SHMFF-Përfitues*

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)

**BASHKIA KORÇË**

Krijim i nje ambjenti te sigurt të fëmijës/familjes	Vlerësimi i kushteve të banesës dhe marrja e masave për sigurimin e një ambienti të sigurt	Menaxheri i rastit dhe përfituesi		Siguri për fëmijën/familjen
Niveli i rrezikut i përcaktuar – i ULET/i lartë		Stafi i qendres Banorja	Sipas nevojave	Siguri per banoren dhe fëmijën
Përfituesi/ja dëshiron të kryejë zgjidhjen e martesës apo noterizim apo mbështetje për dokumentacion për ndihmë ekonomike,	Keshillim ligjor me juristin per: -përfituesja dëshiron të kryej procedurat e divorcit	Menaxheri i rastit dhe përfituesi		Marrja e UM Keshillime ligjore Hartimi i kerkese padise Zgjidhja e martesës
Pajisja me kartë identiteti	-blerja e kuponit - pagesë transporti për në vendbanim	Menaxheri i rastit dhe përfituesi		
Rregjistrim pranë gjëndjes civile	-kryerja e procedurave -lehtësim transporti -Ndarje nga trangu familjar	Menaxheri i rastit dhe përfituesi		

**Marrëdhënia Familjare ( mund të jetë opsionale )**

Objektivi	Veprimet/Aktivitetet	Personi pergjegjes	Data e vleresimit/shqyrtimit	Treguesi i suksesit
-----------	----------------------	--------------------	------------------------------	---------------------

*Marrëveshje tip bashkëpunimi SHMFF-Përfitues*

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



**BASHKIA KORÇË**

Mbajtja e marrëdhënieve në nivel aktual dhe përmirësimi i tyre, kjo në varesi të gjendjes psikoemocionale të fëmijës, shkalles së rrezikut dhe dëshirës së përfituesit/fëmijës	1- kontakte telefonike, me vëllain dhe motrat e saj, te paskten dy here në javë 2- takim me familjarë sipas kërkesës së vetë fëmijës/përfituesit	Menaxheri i rastit/përfituesi	Në çdo tre muaj dhe në varesi të situatave	Përmirësimi i marrëdhënieve dhe lehtësimi i gjendjes emocionale të përfituesit
--	---	-------------------------------	--	--

**Mbështetje Afatgjate ( strehim, rregjistrim i fëmijëve në cerdhe kopshte, shkolla)**

<b>Objektivi</b>	<b>Veprimet/Aktivitetet</b>	<b>Personi përgjegjës</b>	<b>Data e vlerësimit/shqyrtimit</b>	<b>Treguesi i suksesit</b>
Gjetja e një banese me vetë, me qera dhe sigurimi i pageses së qerave për një periudhë të caktuar		Përfituesi /Stafi		Gjetja e një banese me qera
Përgatitja e dokumentacionit për bonus qeraje	Nxjerrja e dokumentave	Menaxheri i rastit / përfituesi	Brenda muajit	Aplikimi pranë zyrave përkatëse
Orientim dhe këshillim për përfitimet financiare	- Hapja e numrit të llogarise dhe marrëdhënia me banken	Menaxheri i rastit dhe përfituesi		Hapja e nr. të llogarise
Përfitim nga efektet e UM/ndihma ekonomike/ etj	- Pagesë ekonomike -	Menaxheri i rastit dhe përfituesi	çdo muaj	Përfiton pagesen nga skema e NE

*Marrëveshje tip bashkëpunimi SHMFF-Përfitues*

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)

**BASHKIA KORÇË**

Rregjistrimi i fëmijëve ne cerdhe /kopësht/shkollë	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatitja e dokumentacionit përkatës</li> <li>- Kryerja e kezhaminimeve të nevojshme për fëmijën</li> <li>- Pajisja me materialet e nevojshme</li> <li>- Shoqërimi i fëmijës cdo ditë në cerdhe nga prindi</li> <li>- Etj...</li> <li>- Kryerja e pagesës së parapagimit</li> </ul>	Menaxheri i rastit dhe përfituesi		Rregjistrimi i fëmijës Dokumentimi në dosje i vërtetimit të rregjistrimit dhe frekuentimit
--	---	-----------------------------------	--	---

**Mbeshtetja Psiko-sociale**

Objektivi	Veprimet/Aktivitetet	Personi pergjegjes	Data e vleresimit/shqyrtimit	Treguesi i suksesit
Lehtesim dhe permiresim i gjendjes emocionale-mbeshtetje emocionale	Seance keshillimi	Psikologjia/përfituesi	Cdo jave ( edhe sipas nevojave)	Permiresim i gjendjes emocionale, aftesim dhe shprehi per perгатitjen ne fazen e riintegrimit dhe fuqizimit

Komente / Shenime:

*Marrëveshje tip bashkëpunimi SHMFF-Përfitues*

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbeshtetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



**BASHKIA KORÇË**

Unë kam marrë pjesë në hartimin e këtij plani ndihme, kam shqyrtuar planin dhe jam dakort që me mundësitë e mia më të mira të marr përgjegjësitë për zbatimin e veprimeve të paraqitura këtu dhe të bëj cdo përpjekje për ta zbatuar këtë plan me sukses.

Unë gjithashtu kuptoj që mund ta ndërpres pjesëmarrjen time dhe të largohem nga programi, nëse unë vendos ta bëj këtë dhe kuptoj dhe mbaj përgjegjësi nëse veprimet e mia ndikojnë në sigurinë dhe mirërritjen e fëmijëve të mi.

Përfituesi: Emri

Firma

Data

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Përfaqësuesi i SHMFF

Firma

Data

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Marrëveshje tip bashkëpunimi SHMFF-Përfitues*

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)

Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS